

27.01.2022
Ora 17:00

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|-------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y.Merkaj |
| Parti | Politike: | PD (I. Sefa), LSI (A. Kaziaj) |
| OJQ: | | KRIK |

Znj. I. Nano: Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, të njoftuar rregullisht për ditën e sotme, ora 17. Të pranishëm në mbledhje janë gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të komisionit. Gjithashtu kemi përfaqësues të një partie politike, zotin Sefa. Rendi i ditës së mbledhjes është njoftuar dhe subjekteve politike, partive politike dhe mediave. Në rendin e ditës kemi 3 projektvendime për të shqyrtuar. I pari është një projektvendim për një

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.27.01.2022*

ndryshim në vendimin nr.11, datë 25.03.2021 të Komisionit Rregullator, për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit. Kemi dy projektvendime të tjera, i pari ky që sapo lexova është iniciativë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kemi dy projektvendime të tjera të propozuara nga një anëtar i Komisionit Rregullator, zoti Muharrem Çakaj. I pari “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator, për miratimin e metodologjisë së monitorimit të mediave audio dhe audio-vizive”, dhe projektvendimi i dytë “Për një shtesë në vendimin nr. 2, datë 22.01.2022, për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjeshme për kryetar, në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje që do të zhvillohen më datën 06 mars 2022”. Paraprakisht më duhet të them që këto projektvendime janë të diktuar, këto ndryshime apo shtesa në vendimet e mëparshme janë të diktuar nga organizimi i zgjedhjeve të pjeshme të datës 06 mars 2022. Duke patur parasysh disa afate që duhet të vendosen apo të rivendosen dhe të përshtaten pikërisht me aktin tonë nr. 2, për miratimin e afateve procedurale. Më lejoni t’ju pyes kolegë dhe përfaqësues të partive politike, nëse keni ndonjë çështje jashtë rendit të ditës, për të diskutuar? Nëse jo, fillojmë shqyrtimin e projektakteve, të cilat janë njoftuar dhe i kemi në rendin e ditës. Projektvendimi i parë, po i drejtohem Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të prezantojë ndryshimin e propozuar, zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Presidenti i Republikës me dekretin nr. 13438, datë 20.01.2022 ka caktuar datën 6 mars për zhvillimin e zgjedhjeve të pjeshme vendore për kryetar bashkie, në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Komisioni Rregullator me vendim nr.11, datë 25.03.2021, ka miratuar rregullat për mënyrën e ngritjes dhe të organizimit të funksionimit të Komisionit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.27.01.2022*

të Qendrës së Votimit dhe zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit. Në lidhjen nr. 3 të këtij vendimi, titulli i lidhjes është “rregullat që përdoren dhe specifikimet teknike të kamerave regjistruese të qendrave të votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, duke identifikuar që këto do të përdoren vetëm në datën 25 prill 2021. Duke qenë se kemi zgjedhje të pjesshme vendore dhe me qëllim që ky vendim të mund të përdoret edhe për çdo lloj zgjedhesh të tjera, kemi propozuar që titulli i lidhjes nr. 3, të bëhet, “rregullat e përdorimeve dhe specifikimeve teknike të kamerave regjistruese në qendrat e votimit” duke hequr shprehjet për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Atëherë, nisim diskutimin në parim të projektvendimit. Kush dëshiron të marrë fjalën? Nëse keni diçka, qoftë përfaqësuesit e partive politike, apo anëtarët e Komisionit? Sikundër Sekretari i Përgjithshëm e theksoi në relatimin e tij, bëhet fjalë për një ndryshim të vogël, duke hequr një shprehje që lidhej me zgjedhjet e 25 prillit, por nëpërmjet këtij ndryshimi mundësojmë që akti të përdoret në të gjitha zgjedhjet, qoftë ato të përgjithshme, qoftë vendore të pjesshme apo të parakohshme. Nëse nuk kemi diçka në parim për projektaktin, ju ftoj ta votojmë atë.

Kush është dakord, kolegë?


Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen, sipas pikave të projektvendimit. Pika e parë, titulli i lidhjes nr. 3 që i bashkëlidhet vendimit nr.11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.27.01.2022*

votimit”, ndryshohet si më poshtë vijon, “rregullat e përdorimit dhe specifikimet teknike të kamerave regjistruese në qendrat e votimit”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit. Ftoj edhe njëherë kolegët të votojnë në tërësi projektvendimin. Kolegë?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet projektvendimi!

Vendimi nr. 6

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



27.01.2022
Ora 17:06

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 2, datë 30.01.2021, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- Ilirjana NANO Kryetar
 - Arens ÇELA Anëtar
 - Dritan ÇAKA Anëtar
 - Helga VUKAJ Anëtar
 - Muharrem ÇAKAJ Anëtar
 - Stafi KQZ Y. Merkaj, M. Koja
- Parti Politike: PD (I. Sefa), LSI (A. Kaziaj)
- OJQ: KRIK

Znj. I. Nano: Kalojmë në dy pikat e tjera të rendit të ditës, të cilat siç e theksova në fillim të mbledhjes, kanë ardhur për shqyrtim dhe miratim në Komisionin Rregullator, me propozim të anëtarit të Komisionit, zotit Muharrem Çakaj. Do t’i lutesha zotit Çakaj, të bënte një prezantim të ndryshimeve që ka propozuar dhe më tej të kalojmë në diskutimin e projektakteve. Zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Po, faleminderit



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.27.01.2022*

Kryetare! Atëherë, me vendimin nr.2, datë 30.01.2021 Komisioni Rregullator ka miratuar vendimin, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audio-vizive”. Ky vendim në thelb ka përcaktuar procedurat dhe teknikat e posaçme që ndjek autoriteti i mediave audio-vizive, AMA, për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore. Konkretisht këtu kemi parashikuar dhe një afat 30-ditor duke iu referuar zgjedhjeve të rregullta që zhvillohen dhe në rastin konkret është miratuar për rregullat për monitorimin e fushatës së zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021. Me anë të këtij projektvendimi, nisur dhe nga dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë për dekretimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme, është ndërhyrë në disa nene të të vendimit nr. 2, në mënyrë që të bëhen funksionale dhe të përshtatshme për zgjedhjet e pjesshme. Konkretisht është propozuar që në aktin bazë, pra në vendimin nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator, në pikën 1, të nenit 1, të hiqet fjala “30-ditore” që i referohet fushatës zgjedhore dhe të lihet vetëm fjala “fushatë zgjedhore” dhe në varësi të zgjedhjeve, qoftë zgjedhjet periodike të rregullta, apo zgjedhje të pjesshme, apo të parakohshme, do të përcaktohet metodologjia, si dhe do të përcaktohen dhe afatet dhe procedurat që do të ndjekin AMA për monitorim. Në rastin konkret më shumë i referohemi afateve. Po kështu në nenin 4, pika 1, propozoj të riformulohet si më poshtë, “rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve të fundit para datës, përfshirë dhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit, për zgjedhjet e parakohshme dhe, ose të pjesshme”. Pra, kjo është shtesa “rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 3 ditëve të fundit, para datës së zgjedhjeve”. Pra duke qenë se kemi të bëjmë me zgjedhje të pjesshme është propozuar afati 3 ditë përfshirë dhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit. Pika 4, pra propozimi i tretë për ndryshim po në aktin, vendimin nr. 2 të Komisionit Rregullator, konsiston në riformulimin e pikës 4 të nenit 5, e cila më pas impakton në propozimin për ndryshime në aktin bazë që

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.27.01.2022*

kemi miratuar në datën 22.01.2022. Konkretisht pika 4 e nenit 5 riformulohet si më poshtë “për veprimtaritë e institucioneve publike, monitorimi i OSHMA-ve fillon 4 muaj para datës së zgjedhjeve dhe bëhet nga ora 08:00 deri në orën 00:00, ose sipas rastit deri në përfundimin e programit”. Për zgjedhjet..., pra shtesa në aktin bazë është kjo “për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme afati për monitorimin e veprimtarive të institucioneve publike, përcaktohet me akt normativ të posaçëm të Komisionit Rregullator”. Pra, kjo është dispozita tranzitore me anë të të cilës, në varësi së pari të datës së caktimit të zgjedhjeve të pjesshme. Së dyti, të afatit, me akt të posaçëm, po të Komisionit Rregullator, do të përcaktojmë momentin se kur fillon monitorimi. Në këtë kuadër ka lindur nevoja që në aktin e miratuar, po nga Komisioni Rregullator “Për disa afate procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje që do të zhvillohen më datën 6 Mars...”. Pra, akti që kemi miratuar në datën 22 janar, ku kemi propozuar disa afate procedurale, në rastin konkret në vendimin nr. 2, datë 22.01.2022, pas pikës 1 propozohet të shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje “Autoriteti i mediave audio dhe audio-vizive monitoron OSHMA-të për veprimtaritë me karakter publik të institucioneve publike të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, nga data 31 janar 2022, nga ora 08:00 deri në orën 00:00, ose sipas rastit deri në përfundimin e programit”. Pra, këto janë dy aktet të lidhura me njëri-tjetrin që janë propozuar nga ana ime. Faleminderit e nderuar!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj për propozimet! Atëherë fillojmë me diskutimin në parim edhe pse dy aktet janë të ndërvarura njëra me tjetrën, do t'i trajtojmë veç e veç nga pikëpamja procedurale, shqyrtimin dhe miratimin e tyre. Kështu që fillojmë me projektvendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.27.01.2022*

metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audio-vizive”. Çelimi diskutimin në parim. Kolegët, përfaqësuesit e partive politike? Zoti Sefa?


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jemi dakord me propozimet e anëtarit Çakaj. Mendoj që i shërbejnë edhe procesit duke pasur në konsideratë edhe afatet e papërdorshme prej 4 muajsh në këto zgjedhje, sepse jemi në zgjedhje të parakohshme, normalisht jam dakord dhe duhet të miratohen!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Edhe unë do ta mbështesja propozimin e kolegut për të bërë këto ndërhyrje në aktin për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audio-vizive. Duke patur parasysh si sondazhet, publikimin e tyre dhe afatin e publikimit, qoftë edhe vendosjen e një afati me një akt të posaçëm lidhur me monitorimin nga ana e AMA-së, të veprimtarive të institucioneve publike nga operatorët e shërbimeve të mediave audio-vizive. Zoti Kaziaj, po!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zonja Nano! Edhe unë e mbështes plotësisht propozimin e bërë nga anëtari i Rregullatorit, zoti Çakaj. Përsa i përket pjesës së monitorimit është një veprimtari shumë e rëndësishme, e cila nuk duhet të anashkalohet, përkundrazi. Zgjedhjet e shkuara për Kuvendin na kanë dhënë një, në qoftë se mund ta quajmë, një leksion të mirë, në thonjëza, jo vetëm te pjesa e afatit procedural që është adaptuar në këtë rast, në rastin e zgjedhjeve të pjesshme vendore, por dhe në faktin e ndikimeve që mund të kenë institucione të caktuara publike, në dhënien e aksesit më shumë tek disa subjekte të caktuara politike, sesa le të themi, te disa të tjera, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Kaziaj dhe më lejoni që në emër të Komisionit Rregullator t’ju drejtohem juve si përfaqësues të partive politike, që duke pasur

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



të drejtën që të propozoni edhe ju me shkrim, ndryshime të mundshme apo dhe vetë projektakte, do ta konsideroja një ndihmë ndaj Komisionit Rregullator, nëse dhe ju do të vëreni çështje për të cilat kanë nevojë për ndërhyrje, për këto zgjedhje dhe do t'i mirëprisnim propozimet tuaja për t'i shqyrtuar. Nëse nuk ka diskutime të tjera kalojmë në votimin në parim të projektvendimit "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audio-vizive".

Kush është dakord në parim me projektvendimin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në pikën 1, është nevoja ta lexoj? Nuk e besoj se zoti Çakaj që ishte propozuesi e lexoi të gjithë propozimin vet! Po, zoti Sefa!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Një propozim, ndryshim të vogël kam, në lidhje me afatin, 3 ditët e fundit para zgjedhjeve. Në qoftë se është mundësia që të linim dhe ditën e premtë, pa hyrë heshtja zgjedhore që është dita e shtunë dhe dita e diel, ta linim dy ditë para zgjedhjeve.

Znj. I. Nano: Zonja Koja, po!

Znj. M. Koja: Dua thjesht të sjell në vëmendje që ky është përcaktimi i Kodit Zgjedhor, vetëm kaq. Mbasi e dërgoi zoti Çakaj, unë verifikova pak përputhshmërinë me kodin, për një verifikim të dytë dhe kjo është ekzaktësisht siç e kemi pasur.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Duke pasur parasysh që nuk ka dhe shumë kohë dhe normalisht, sondazhet shërbejnë edhe në lidhje me krijimin e perceptimit të zgjedhësve, por është zgjedhje e Komisionit Rregullator.

Znj. M. Koja: Të bëhet dy ditë, po propozoni?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po! Dy ditët e fundit. Domethënë është e shtuna dhe e diela. Duke qenë se e shtuna është heshtje zgjedhore dhe e diela heshtje zgjedhore.

Znj. M. Koja: Unë kisha merakun vetëm çështjen para datës, përfshirë dhe datën deri në mbylljen e votimit, këtë e kam merak të qëndrojë ekzaktësisht.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Dita e premte që i bie deri në 12:00.

Znj. M. Koja: E vlerëson propozuesi, faleminderit!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Dakord! Ne nuk është se kemi ndonjë problematikë të madhe në lidhje me këtë!

Znj. I. Nano: Në rregull! Zonja Hoxhaj, këshilltarja e mediave të KQZ-së dhe është personi që e ndjek nga më afër se kushdo tjetër këtë proces, të monitorimit të AMA-s!

Znj. D. Hoxhaj: Pa ndërhyrë në detaje teknike dhe vetë fryma e dispozitës që Kodi Zgjedhor ka vendosur për sondazhet dhe ndalimin për publikim të sondazheve në një afat të caktuar, ka për qëllim respektimin e të drejtës së qytetarëve që të kenë kohën e tyre të mjaftueshme për të krijuar bindjen dhe

mendimin e tyre për alternativën që do të zgjedhin. Në zgjedhje normale kjo është jo më vonë se 5 ditë. 5 ditët e fundit, përfshirë heshtjen zgjedhore dhe përfshirë ditën e zgjedhjeve, që do të thotë shkon në total 7. Për zgjedhjet e pjesshme mendoj që mund të mos jetë 5, aq sa zoti Çakaj e ka propozuar, por patjetër që duhet të ketë një kohë që zgjedhësi të ketë mundësinë, t'i respektohet e drejta e tij për të patur një afat për të vendosur. Sondazhet ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në krijimin e opinionit dhe në mendimet e zgjedhësve, faleminderit!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jam dakord! Tërhiqem nga propozimi!

Znj. I. Nano: Në rregull, faleminderit! Mesa duket edhe propozuesi në këtë rast, zoti Çakaj ka dashur të implementojë frymën e ligjit në rastin e këtij akti të posaçëm për zgjedhjet e pjesshme dhe/ose të parakohshme, për të krijuar një hapësirë sado të vogël të zgjedhësit për t'u shkëputur nga rezultatet e sondazheve dhe për të reflektuar mbi alternativën që do të zgjedhë apo do të votojë ditën e zgjedhjeve. Atëherë nëse s'kemi diskutime të tjera, votojmë pikën 1 të projektvendimit!

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pika e dytë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.27.01.2022*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Votojmë në tërësi projektaktin dhe njëherë ju ftoj kolegë të votoni.

Kush është pro projektaktit në tërësi?

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet në tërësi projektvendimi i propozuar nga zoti Çakaj!

Vendimi nr. 7

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



27.01.2022
Ora 17:20

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr. 2, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|-----------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y. Merkaj, M. Koja |
| Parti | Politike: | PD (I.Sefa), LSI (A.Kaziaj) |

OJQ:

KRIK

Znj. I. Nano: Viojmë me projektvendimin e dytë të propozuar gjithashtu nga anëtari Komisionit Rregullator, zoti Muharrem Çakaj, që sikundër ai relatoi është i ndërvarur nga vendimi që sapo miratuam. Pra, në vendimin që sapo miratuam u përcaktua që afati për zgjedhjet e parakohshme dhe ose të pjesshme, për monitorimin e veprimtarive të institucioneve publike përcaktohet me akt normativ të posaçëm të Komisionit Rregullator. Në fakt ne, në mbledhjen e parë që kemi zhvilluar për këtë periudhë të re zgjedhore, kemi miratuar disa afate

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.27.01.2022*

procedurale dhe ky projektvendim i propozuar nga zoti Çakaj ka saktësuar tashmë këtë afat, nga data 31 Janar 2022 gjithmonë për emisione, për transmetimet nga ora 8 e mëngjesit deri në orën 12 të natës, ose sipas rastit deri në përfundimin e programit. Zoti Çakaj e relatoi, nëse kolegët kanë diçka për diskutim? Përfaqësuesit e partive politike? Pra, është e natyrshme që rrjedh nga vendimi që sapo miratuam. Zonja Vukaj, ka diçka?

Znj. H. Vukaj: Është një saktësim dhe i sugjerova kolegut ta rishohë edhe njëherë, me qëllim që të jetë më e qartë për ata që do marrin aktin në zbatim.

Z. M. Çakaj: Në aktin bazë propozimi konkret, më saktë vendimi që kemi miratuar ne, vendimi nr. 2, datë 30.01.2021, neni 5, pika 4 ishte “AMA kryen monitorimin për veprimtaritë e institucioneve publike në fushatë, monitorimi i OSHMA-ve fillon 4 muaj para datës së zgjedhjeve dhe bëhet nga ora 08:00 deri në orën 00:00, ose sipas rastit deri në përfundimin e programit”, që sigurisht nënkuptohet 4 muaj deri në datën e zgjedhjeve, sepse ajo ishte fryma. Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me zgjedhje të pjesshme është lënë afati nga 31 janar dhe besoj është e kuptueshme që është deri në datën e zgjedhjeve. Megjithatë nëse do të ndërhyjmë në këtë akt, do të duhet të ndërhyjmë dhe tek akti më pas, kështu që unë besoj se është e kuptueshme siç e kemi miratuar në aktin bazë.

Znj. I. Nano: Pra, vetëm afati i fillimit është ndryshuar?

Z. M. Çakaj: Vetëm afati i fillimit është ndryshuar!

Znj. I. Nano: Pra, nga 4 muaj, se nënkuptohet se dhe ditën e zgjedhjeve monitoron AMA. Sepse mund të ketë edhe raste të publikimit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Z. M. Çakaj: Po, deri ditën e zgjedhjeve!

Znj. I. Nano: Monitorimi i AMA-s bëhet pra, ne po flasim edhe për ditën e zgjedhjeve. Ajo çka ne vendosim në këtë akt është...

Z. M. Çakaj: Përfshirë orën e fundit të votimit!

Znj. I. Nano: Ajo ç'ka ne ndryshojnë në këtë akt është vetëm afati i fillimit të monitorimit, nga 4 muaj para ditës së zgjedhjeve, themi data 31, duke patur parasysh afatet e miratuara në aktin e mëparshëm. Nëse nuk kemi diskutime të tjera, kalojmë në votimin në parim të projektaktit.

Kush është dakord ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet në parim projektvendimi!

Kalojmë tek 3 pikat me radhë. Pika e parë, në vendimin nr. 02, datë 22.01.2022 "Për miratimin e disa afateve proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022". Pas pikës 1, i shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje "Autoriteti i mediave audio dhe audio-vizive monitoron OSHMA-të, për veprimtarinë me karakter publik të institucioneve publike, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, nga data 31 janar 2022 nga ora 8:00 deri në orën 12:00, ose sipas rastit, deri në përfundimin e programit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Po, zoti Kaziaj kishte diçka?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Vetëm një saktësim! Gjatë kohës që miratoni aktet dhe pika e tretë që është, të themi, ajo fjalia e përgjithshme që përdoret, Kolegji Zgjedhor, emërtesa e saktë e institucionit është Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, për aktet e tjera ta kemi parasysh.

Znj. I. Nano: Në rregull, atëherë lutem administrata ta verifikojë dhe ta reflektojë këtë në të gjitha aktet ku parashikohet ankimi në Kolegjin Zgjedhor. Atëherë kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet dhe ky projektvendim! Këto ishin 3 projektvendimet që kishim në rendin e ditës për shyrtim dhe miratim. Nuk kemi çështje të tjera jashtë rendit të ditës, kështu që e deklaroj mbledhjen të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 8

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

